



REPUBLIKA E SHQIPERISE

Gjykata e Shkallës së Parë e
Juridiksionit të Përgjithshëm
Shkodër

Detaje te ceshtjes civile me numer: 21274-01317-51-2024

Nr. i Ceshtjes	21274-01317-51-2024
Titulli i ceshtjes	***** [Paditës] Kundër: ***** [I Paditur]
Dt. e Regjistrimit	10/29/2024 12:00:00 AM
Lloji i ceshtjes	Kundershtim veprimesh permbarimore
Baza ligjore	
Statusi i ceshtjes	Mbyllur
Gjyqtari	Arta Llazari
Nr. i vendimit	51-2024-4461
Dt. e vendimit	12-09-2025

Informacion per palet e ceshtjes

Emri	Tipi
*****	I Paditur
*****	Paditës



REPUBLIKA E SHQIPERISE

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm

Shkodër

licensë nr.1059 dhe me nuis K77319004G, sipas dëshirës së tij shprehur para kësaj gjykate, me nr.tel.cel: 068 207 9977;

Zyra Përmbartimore Shkodër, përmbartues **Tauland Muja**, me seli në bashkia Shkodër, rruga "Don Bosko", pranë Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër;

Kundërshtim i vendimit të Zyrës Përmbartimore Shkodër nr.116.dkp prot.4354, datë 28.10.2024 për "Pezullimin e ekzekutimit të urdhrin të ekzekutimit";

Nenet 31, 32 dhe 617 të Kodit të Procedurës Civile.

Gjykata, pasi vendosi të zhvillojë gjykimin në prani të kërkuarit/ankues ***** ***** ***** , si dhe mbrojtëses së tij, dhe në prani të subjektit të interesuar Zyra Përmbartimore Shkodër, dëgjoi përfaqësuesen e kërkuarit, si dhe këtë të fundit, të cilët paraqitën kërkesë dhe aktet provuese në mbështetje të saj, si dhe personin e interesuar, i cili pranoi provat e paraqitura nga pala kërkuar, i ftoi palët e pranishme në gjykimin përfundimtar, gjatë të cilit përfaqësuesja e kërkuarit kërkoj pranimin e kërkesës së tij sipas objektit të paraqitur, si dhe personi i interesuar kërkoj rrëzimin e ankimit si të pabazuar në prova dhe në ligj. Gjykata, pasi dëgjoi dhe vlerësoi kërkesën dhe provat e paraqitura para saj,

Vëren

Para kësaj gjykate, më datë 28.10.2024, është sjellë për gjykim padia e ngritur nga kërkuar/ankues ***** kundër Zyrës Përmbartimore Shkodër, me përmbartues Tauland Muja, me anë të së cilës është kërkuar kundërshtimi i vendimit me nr.116.dkp prot.4354, datë 28.10.2024 për "Pezullimin e ekzekutimit të urdhrin të ekzekutimit". Pa verifikuar nga kryesekretaria e kësaj gjykate nëse gjatë këtij procesi ekzekutimi ka pasur ankesa apo kundërshtime të veprimeve përmbartimore, të cilat mund të jenë shqyrtuar nga gjyqtarë të tjerë, referuar parashikimit të nenit 610 të Kodit të Procedurës Civile (në vijim KPC), i cili parashikon: "...Ankimet kundër veprimeve ose refuzimit të përmbartuesit gjyqësor shqyrtohen nga i njëjti gjyqtar i vetëm gjatë gjithë fazës së ekzekutimit të detyrueshëm të titullit ekzekutiv kur veprimet ose refuzimi i përmbartuesit gjyqësor lidhet me të njëjtin titull ekzekutiv, përveç rasteve kur ligji parashikon ndryshe.", kjo çështje i është caktuar me short elektronik datë 29.10.2024 kësaj gjykate (gjatë këtij procesi gjyqësor palët ndërgjyqëse paraqitën një vendim gjyqësor nr.618(3341), datë 11.07.2024, me gjyqtare A.B.(T), e cila ka marrë në shqyrtim një ankesë e debitorëve të këtij konflikti kundër Zyrës Përmbartimore Shkodër.). Bazuar në nenet 32, 35, 36, 41, 49, 50 dhe 467 të Kodit të Procedurës Civile (në vijim KPC), kjo gjykatë është kompetente për të marrë në shqyrtim këtë kërkesë/ankesë, pasi është gjykata e vendit ku është caktuar të ekzekutohet ky titull ekzekutiv, është një gjykim që zhvillohet nga një gjyqtar i vetëm, sipas shortit elektronik.

Nga shqyrtimi gjyqësor i kësaj kërkesë rezultoi se:

Me cilësinë e kreditorit, kërkuar/ankues ***** i është drejtuar Zyrës Përmbartimore Shkodër me qëllim që të fillonte dhe të ekzekutohej urdhrin e ekzekutimi nr.20, datë 28.06.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, urdhrin e ekzekutimi nr.352, datë 22.07.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, lëshuar për vendimin nr.119, datë 11.02.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, vendimin nr.105, datë 27.03.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, nr.778, datë 27.03.2023 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, me objekt gjykimi "Kthim dhe lirim sendi, si rezultat i vendimit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Shkodër dhe kontratës së privatizimit nr.9949.rep dhe nr.1734.kol, datë 02.11.2012 me Ministria e Financave dhe kreditorit *****.

Më 10.10.2022, subjekti i interesuar, Zyra Përmbartimore Shkodër, me urdhrin e regjistrimit nr.116.dkp.regj ka vendosur: "Regjistrimin e urdhrin nr.20, datë 28.06.2010 të Gjykatës Shkodër (shënim gjykatës duhet të jetë "Gjykata e Apelit Shkodër") nga ana e sekretarisë së Zyrës përmbartimore



REPUBLIKA E SHQIPERISE

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër

Shkodër. ..."

Sipas këtij urdhri duhet të ekzekutohet vendimi nr.1158, datë 05.07.1996 i Komisionit të Kthimit e Kompensimit të Pronave, vendimi nr.119, datë 11.02.2002 i Gjykatës Shkodër, për të cilin është lëshuar urdhër i ekzekutimit nr.20, datë 28.06.2010 të Gjykatës së Apelit Shkodër, duke u listuar emrat e debitorëve të cilët duhet të lironin vullnetarisht pronën e kreditorit *****.

Më datë 13.10.2022, me shkresën menr.116/dkp regj.2158, kanë filluar veprimet përmbartimore me "Lajmërim për ekzekutim vullnetar", drejtuar, fillimisht, 32 (tridhjetë e dy) personave, sipersona të cilët qëndrojnë forcërisht dhe në kundërshtim me ligjin. Ky ekzekutim vullnetar duhet të kryhej brenda 10 ditëve nga marrja e vendimit nr.1158, datë 05.07.1996 i Komisionit të Kthimit e Kompensimit të Pronave dhe vendimit nr.119, datë 11.02.2002 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, për të cilin është lëshuar urdhër i ekzekutimit nr.20, datë 28.06.2010 të Gjykatës së Apelit Shkodër, duke liruar vullnetarisht pronën e kreditorit *****.

Më datë 31.10.2022 me shkresën nr.116.dkp.regj.prot.2616 është vendosur kalimi në ekzekutim të detyrueshëm për urdhrin e ekzekutimit nr.20, datë 28.06.2010 të Gjykatës së Apelit Shkodër, pasi nga debitorët nuk është zbatuar vullnetarisht ky vendim. Ndonëse subjekti i interesuar i ka kërkuar ndihmë dhe mbështetje Drejtorisë së Policisë së Qarkut Shkodër, kjo e fundit ka paraqitur një padi për kundërshtimin e veprimeve përmbartimore. Një kundërshtim të tillë kanë bërë dhe debitorët, duke paraqitur padi apo ankesa si në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, ashtu dhe në Gjykatën Administrative të shkallës së parë Shkodër dhe Tiranë. Drejtoria e Policisë së Qarkut Shkodër ka paraqitur një ankesë dhe në Ministrinë e Drejtësisë, ashtu dhe tek Drejtori i Përgjithshëm i Përmbartimit. Nga ana e kësaj të fundit është arritur konkluzioni se subjekti i interesuar ka gabuar që në momentin e regjistrimit dhe pranimit për ekzekutim të kërkesës së paraqitur nga ankuesi *****.

Më 28.10.2024 ***** ka marrë vendimin objekt gjykimi me nr.116 dkp Prot.4354. Sipas këtij vendimi është vendosur: "1. *Pezullimi i ekzekutimit të Urdhrit të ekzekutimit nr.20, datë 28.06.2010 të Gjykatës Shkodër dhe urdhri i ekzekutimit nr.352, datë 22.07.2014 të Gjykatës Shkodër, deri në shprehjen e Gjykatës me vendim të formës së prerë mbi procedurën përmbartimore ose interpretimin e vendimit të kërkuar nga vetë pala ******; 2. *Mbi këtë vendim pezullimi të njoftoj palën e interesuar, e cilabrenda 5 (pesë) ditëve nga dita e njoftimit apo marrjes së dëgjimit, ka të drejtën e ankimit pranë Gjykatës së Shkallës së Parë e juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.*".

Siç u citua më sipër, ndaj këtij vendimi ankuesi/kreditori ***** ka paraqitur ankesën objekt të këtij gjykimi, duke kërkuar shfuqizimin e vendimit me nr.116.dkp prot.4354, datë 28.10.2024 për "Pezullimin e ekzekutimit të urdhrit të ekzekutimit", duke e detyruar Zyrën e Përmbartimit Shkodër të vazhdojë procedurat e ekzekutimit të urdhrit të ekzekutimit.

Ankuesi ***** pretendon se ai është pronar i një trualli dhe i godinës së ndërtuar mbi të që nga viti 2012, pasi truallin e kafituar me vendim të KKKP Shkodër ndërsa godinën e ndërtuar mbi të e kaparablerë, si pronar i truallit. Për të dyja këto sende ai është regjistruar në ASHK Shkodër si pronar i vetëm i tyre. Edhe pse pronarë ligjor i këtyre dysendeve ai prej më shumë se 12 vitesh nuk mund t'i disponojë dhe gëzojë këto sende. Duke qenë të rrezikuara si ai si pronar i pasurive të paluajtshme dhe subjekti i interesuar si përmbartues dhe ekzekutues i vendimeve gjyqësore nga sjelljet dhe veprimet e debitorëve që kanë zënë me forcë këto sende, është kërkuar mbi 30 herë prania e forcave policore gjatë kryerjes së veprimeve përmbartimore për lirim të sendeve, por pavarësisht këtyre kërkesave Drejtoria Vendore e Policisë Shkodër ka refuzuar mbështetjen e saj në këtë procedurë. Duke zbatuar parashikimet ligjore të nenit 606 të KPC-së, ***** ka gënjatur disa herë debitorët dhe zaptuesit e pronave të tija edhe më pas dhe vetë Drejtorinë Vendore të Policisë Shkodër. Pavarësisht kërkesave dhe ankesave të bëra prej tij tek Ministria e Drejtësisë, tek Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit e të tjera, ekzekutimi ka ndaluar për lirim të 3 banesave qëndrohen në posedim të tre personave, të cilët dhe ata i kanë kundërshtuar veprimet përmbartimore në gjykatë. Nga ana e saj gjykata e të dyja shkallëve uaka rrëzuar ankesat këtyre zaptuesve. Por, si papritur, më 28.10.2024 Zyra e Përmbartimit Shkodër ka vendosur ta pezullojë procesin e ekzekutimit. Brenda afatit 5 ditor ai si kreditor ka paraqitur ankesën kundër vendimit të pezullimit të veprimeve



REPUBLIKA E SHQIPERISE

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm

Shkodër
përmbartim. Në vlerësimin e tij një vendim i tillë nuk është në kompetencën e përmbartuesit, por në kompetencë dhe mundësi të gjykatës. Mosekzekutimi i vendimeve të gjykatës përbën shkelje të rëndëkushtetuese. Pezullimi i ekzekutimit është i pambështetur në ligj dhe atij sikreditor dhe familjes së tij i ka sjellë pasoja të rënda psikologjike dhe ekonomike. Baza ligjore e vendosur nga përmbartuesi, neni 617 i KPC-së është igabuar, pasi pezullimi parashikohet në nenin 615 të KPC-së. Përfundimisht, ankuesi kërkon të shfuqizohet vendimi i pezullimit dhe përmbartuesi të detyrohet të vijojë ekzekutimin titujve ekzekutivë, sipas kërkesës së kreditorit/ankuesi***** , referuar ankimit dhe diskutimit përfundimtar, datë 08.11.2024.

Subjekti i interesuar Zyra Përmbartimore Shkodër, pasi kaparashtruar në mënyrë të përmbledhur gjitha veprimet e veta përmbartimore, sidhe ecurinë e proceseve gjyqësore që janë lidhur me kundërshtimet e paraqituras nga kreditori, debitorët e këtij procesi përmbartimor, ashtu dhe subjektet etreta të interesuara për këtë ekzekutim, ka shprehur qëndrimin e saj lidhur me ankesën e paraqitur së fundmi nga kreditori, ankuesi ***** , duke pretenduar se: "... *Nisur nga vendimet gjyqësore që bien në kundërshtim me njëri-tjetrin, vendimet administrativ të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbartimit, si dhe kërkesës së palës kërkuese ***** , i cili në bazë të nenit 314 të KPC-së, pikërisht për zgjidhjen e ngërçit ligjor, i është drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër me kërkesë për interpretimin e vendimit nr.119, datë 11.02.2002 të Gjykatës Shkodër, nr.105, datë 27.03.2002 të Gjykatës Shkodër dhe vendimit nr.778, datë 27.03.2013 të Gjykatës Shkodër, kërkon rrëzimin e ankimit si të pabazuar në ligj dhe në prova.*

Sipas përmbartuesit gjyqësor në mbështetje të këtij qëndrimi është dhe vendimi nr.618(3341), datë 11.07.2024 i Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, i cili ka pranuar padinë e paraqitur nga 13 (trembëdhjetë) debitorë, të cilët kanë kundërshtuar gjatë tyre nga përmbartuesi për mos zbatim të vendimit të tij. Konkretisht ky vendim gjyqësor, tek pjesa arsyetuese e tij ka argumentuar se i vetmidebitor i vendimeve gjyqësore të hapura nga kreditori ***** është KKKP Shkodër dhe jo paditësit (ankuesit). Nuk i takon përmbartuesit gjyqësor që të vendosë me interpretim të zgjeruar nëse paditësit duhet të kryejnë ndonjë veprim dhe çfarë veprimi duhet të kryejnë. Në çmim të kësaj gjykate konfliktimes paditësve dhe familjes ***** lidhur me pasurinë objekt gjykimi duhet të zgjidhet me një gjykim themeli mes këtyre palëve, sipas kërkesave të ligjit procedural civil dhe kodit civil. Për sa kohë nuk ka një vendim të tillë që të detyrojë paditësit të kryejnë një veprim të caktuar, përmbartuesi gjyqësor nuk mund të ndërhyjë vetë dhe të vendosë që paditësit duhet të kryejnë veprime të cilat nuk rezultojnë nga ndonjë titull ekzekutiv. Nga ana tjetër, meqenëse konflikti mes palëve i takon gjykatës që ta zgjidhë, gjykata çmon sepërmbartuesi nuk mund të urdhërojë kryerjen e disa veprimeve që i takon vetëgjykatës që t'i disponojë.", referuar diskutimit përfundimtar datë 08.11.2024 të Zyra Përmbartimore Shkodër.

Gjykata, në vlerësim të kësaj kërkesë/ankese të paraqitur nga shtetasi ***** Nga si dhe akteve bashkangjitur saj, ubind se kërkesa nuk është e bazuar në ligj dhe në prova, konkretisht:

Neni 617 i KPC shprehimisht parashikon: "Pezullimi i ekzekutimit, përveç rastit kur vendoset nga gjykata, si dhe pushimi i ekzekutimit vendosen nga përmbartuesi gjyqësor. ...". Në interpretim literal dhe logjik të këtij parashikimi ligjor, rezulton se subjekti që lejohet të vendosë për pezullim dhe pushimin e ekzekutimit, është edhe përmbartuesi gjyqësor, përveç atyre rasteve kur shprehimisht dhe qartazi një vendim të tillë e ka marrë gjykata. Pra, nuk qëndron pretendimi i kërkuarit/ankues se përmbartuesi, referuar nenit 615 të KPC-së nuk ka të drejtë të marrë vendim pezullimi të veprimeve përmbartimore.

Referuar po kësaj dispozite, nenit 615/çtë KPC-së, mund të pezullohet ekzekutimi "*në rastet e tjera të parashikuara nga ligji*", në vlerësim të kësaj gjykate në rastin objekt gjykimi është situata kur përmbartuesi është kushtëzuar nga vijimi i gjyqësorëve të filluara nga 13 paditësit/debitorë të pretenduar si të tillë ngakreditor ***** dhe argumentimi që gjykata e shkallës së parë ka bërë përpozicionimin e tyre në këtë procedurë, duke i thënë përmbartuesit që nuk të takon ty si përmbartues që të interpretosh në mënyrë të zgjeruar vendimet gjyqësore duke i detyruar paditësit të kryejnë apo mos kryejnë ndonjë veprim konkret, pasi debitor i vetëm i kësaj procedure përmbartimore është vetëm KKKP Shkodër. Për sa kohë ky vendim gjyqësor nuk ka marrë formë të prerë, fakt i pranuar nga të dyja palët e këtij procesi gjyqësor, përmbartuesi gjyqësor me të drejtë ka vlerësuar se nuk mund të vijojë me procedurën e ekzekutimit, derisa çështja civile e hapur nga personat që janë gjatë për të, që pretendohet se janë poseduesit dhe zaptuesit e paligjshëm të



REPUBLIKA E SHQIPERISE

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm

sendit, godinës dhe truallit nëpronësi të ankuesit/kreditörit ***** Shkodër, nuk është mbyllur me vendim tëformës së prerë, referuar parashikimeve të nenit 297/a të KPC-së.

Në këto kushte, kjo gjykatë e gjenlegjitim subjektin përmbarues gjyqësor në marrjen e vendimit të pezullimit tëprocedurës ekzekutive, si dhe të drejtë në vlerësim të rrethanave se kur mundtë vendoste ai, përmbaruesi gjyqësor, këtë pezullim. Për këtë arsye nuk e gjentë bazuar ankesën e paraqitur nga shtetasi ***** kundër ZyrësPërmbarimore Shkodër.

Për këto arsye,

Gjykata,bazuar në nenet 297, 615 dhe 617 të Kodit të Procedurës Civile,

Vendosi

- Mospranimine kërkesës/ankesës së paraqitur nga ankuesi ***** kundër ZyrësPërmbarimore Shkodër për kundërshtimin e vendimit me nr.116.dkp prot.4354, datë28.10.2024 për “Pezullimin e ekzekutimittë urdhrin të ekzekutimit”, si kërkesë e pambështetur në ligj dhe në prova;
- Shpenzimetgjyqësore, siç janë bërë;
- Kundërkëtitj vendimi, palët e pranishme në këtë gjykim, mund të paraqesin ankim nëGjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, brenda afatit ligjor.

Shkodër, datë 08.11.2024, ora 12:45.

Sekretare seance

Esmeralda Kukaj

Gjyqtare

Arta Llazari

SHPENZIMET GJYQËSORE

(Sipas neneve102,106 të KPC-së)

Taksë regjistrimi 3000 Lekë

Për njoftime Lekë

TOTALII SHPENZIMEVE:3000 Lekë

Sekretare gjyqësore

Esmeralda Kukaj



REPUBLIKA E SHQIPERISE

Gjykata e Shkallës së Parë e
Juridiksionit të Përgjithshëm
Shkodër

Dispozitivi

VENDOSI`<?xml:namespace prefix = o ns = "urn:schemas-microsoft-com:office:office"`

1. Rrëzimin e padisë së paraqitur nga paditësi Gjon Shkambi kundër të paditurës Zyra Përmbarimore Shkodër, për kundërshtimin e veprimit përmbarimor “Vendimit të Zyrës Përmbarimore Shkodër nr. 116 dkp prot 4354, datë 28.10.2024 “ për pezullimin e ekzekutimit të urdhërti të ekzekutimit”, si padi e pambështetur në ligj dhe në prova;
2. Shpenzimet gjyqësore, siç janë bërë;

Kundër këtij vendimi lejohet ankim, brenda afati ligjor, në Gjykatën e Apelit Shkodër.

Shkodër, më 08.11.2024, ora 1245.

Sekretare seance

Esmeralda Kukaj

Ky dokument është marrë nga www.gjykata.gov.al. Ai ka vlerë të plotë informuese, por nuk shërben si dokument zyrtar. Ky i fundit lëshohet nga autoritetet përkatëse.